



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1488 Prot.

Tiranë, më 14.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 42, datë 14.08.2025

**“PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE TË CIKLIT TË TRETË
“MASTER EKZEKUTIV”, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 6, pika 30, neni 47 dhe neni 49; në Statutit të UMT-së neni 5 dhe 51; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018, i ndryshuar; në propozimin e Fakultetit të Mjekësisë Dentare me shkresën nr. 190/1 prot., datë 16.04.2025, si dhe në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 92, datë 11.08.2025 “Për tarifat e shkollimit për programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit të UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studentët e regjistruar në programet e përbashkëta të studimit, të cilët nuk përfundojnë programin përkatës të studimit apo nuk shlyejnë të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, brenda kohëzgjatjes normale të tij, do të trajtohen sipas përcaktimeve në marrëveshjet specifike dhe rregulloret përkatëse të programeve të sipërcituara, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETAR
MONIKA FIDA

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ

Tabela nr.1: Tarifatat e shkollimit për programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2025-2026

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i Studimit	Tarifë vjetore
1	F. i Mjekësisë Dentare	II	Master Profesional/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Parë në “Higjenë Dentare dhe Terapi Parodontale jo Kirurgjikale”	4000 EU
2	F. i Mjekësisë Dentare	III	Master Ekzekutiv/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Dytë në “Implanto Protetikë”	6000 EU

